


AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

(ASIG)

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

RAPORT PËR INSTITUCIONET E VARËSISË

Përmbajtja

RAPORT PËR INSTITUCIONET E VARËSISË	1
I. Objektivat 2024.....	1
Aktivitetet e realizuara	2
II. Problematikat e evidentuara	8
III. Objektivat Viti 2025	8

I. Objektivat 2024

Për vitin 2024, ASIG ka identifikuar dhe planifikuar realizimin e objektivave të përgjithshme si më poshtë:

1. Krijimi i GIS-it Kombëtar dhe funksionimi i Gjeoportalit Kombëtar, për të ofruar informacion gjeohapësinor të përditësuar dhe me standarde në funksion të vendimmarrjeve të drejta për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit.
2. Ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i KRGJSH-së si sistem referues gjeodezik i saktësisë së lartë dhe i unifikuar me sistemin evropian, në funksion të realizimit të punimeve gjeodezike dhe krijimin e Hartës Bazë sipas standardeve bashkëkohore.
3. Mbarëvajtja e projektit “Shërbime Satelitore” në kuadër të Monitorimit të Territorit me Teknologji të Avancuar.
4. Harmonizimi i të dhënave gjeohapësinore ekzistuese dhe krijimi i të dhënave të reja për temat e gjeoinformacionit, veçanërisht i Hartës Bazë, në përputhje me standardet e miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Sigurimi dhe menaxhimi i burimeve financiare (nga buxheti i shtetit dhe financimet e huaja), menaxhimi i burimeve njerëzore dhe sigurimi i shërbimeve mbështetëse për plotësimin e kërkesave dhe nevojave të institucionit për të garantuar input-et e nevojshme për realizimin e objektivave teknike të tij.

Për përmbushjen e objektivave të mësipërme, për vitin 2024 nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), janë realizuar detyrat nga drejtoritë përkatëse si më poshtë:

Aktivitetet e realizuara

- Ndjekja e projektit "Përmirësimi i Sistemit të Gjeoportalit Kombëtar", i cili ka përfunduar kontratën më Tetor, 2024. Monitorimi, kontrolli dhe mirëmbajtja ka vijuar të kryhet sipas urdhrit nr.53, datë 16.02.2023, "Për administrimin e Gjeoportalit Kombëtar" gjithashtu është hartuar dhe dorëzuar dokumentacioni i nevojshëm për këtë proces. Janë kryer periodikisht proceset e Back-up dhe Restore të sistemit.
- ASIG në bashkëpunim me Autoritetet Publike Përgjegjëse për temat e gjeoinformacionit, të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ka vazhduar procesin e përditësimit dhe harmonizimit me standardet shtetërore të të dhënave gjeohapësinore për tematikat:
 - Tema "Korniza Referuese Gjeodezike (KRGJSH)", të dhënat për Rrjetin Shtetëror të Pozicionimit Global dhe Rrjeti Shtetëror Gravimetrik, të përgatitura nga ASIG.
 - Tema "Kufijtë e Njësive Administrative", të dhënat për Rendin 4 për Kufijtë e Njësive Administrative Kamëz dhe Malësi e Madhe, Rendi 5 Fshatra, Qytete, Malësi e Madhe, të përgatitura nga Bashkitë përkatëse.
 - Tema "Ortoimazheria", të dhënat gjeohapësinore Ortoimazheri dhe Mbulesa Ortoimazherike për:
 - Ortofoto Satelitore viti 2024 (RGB & CIR);
 - Ortofoto Satelitore viti 2023 (RGB & CIR);
 - Ortofoto Historike 1957.
 - Tema "Parcelat Kadastrale" dhe "Ndërtesa". Të dhënat për Zonat Kadastrale dërguar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në momentin e regjistrimit fillestar. Tema "Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare", të dhënat për 'Institucionet Publike' të përgatitura nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor:
 - "Sistemi i Drejtësisë";
 - "Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor";
 - "Institucionet Shëndetësore".Të dhënat për nën temën *Rrjetet e gazifikimit* të përgatitura nga operatori i kombinuar i transmetimit dhe shpërndarjes së gazit në Shqipëri, ALBGaz.
 - Tema "Hidrografia", të dhënat për AMBU, lejet e dhëna nga KKU dhe KBU-të për përdorimet e burimeve ujore për:
 - Veprimtari ndërtimore në brigje;
 - Shfrytëzimin e materialeve inerte në brigjet e lumenjve/përrenjve, Qëllime kurative dhe termale, Akuakulturë;
 - Ujitje në bujqësi, industri dhe teknologji;
 - Hidroenergji, HEC-et;
 - Përdorime të tjera të ujit: sanitar, lavazhe, familjar sanitar, pishina, inbotilim;
 - Tema "Përdorimi Tokës", të dhënat për "Kufi njësie strukturore dhe përdorimi i tokës", "Kategoritë e propozuara të përdorimit të tokës", "Plani Gjeohapësinor" të përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT).

- Tema “Pedologjia”, të dhënat për “Pedologjinë” të përgatitura nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë (QTTB).
 - Tema “Infrastruktura për Monitorimin e Mjedisit”, të dhënat për “Viti 2022”, “Viti 2023” të përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM).
 - Tema “Infrastruktura Bujqësore dhe Akuakultura”, të dhënat për “Zonat e përcaktuara për Akuakulturë”, të përgatitura nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).
 - Tema “Zonat e Mbrojtura”, të dhënat për “Zonat e Mbrojtura të Trashëgimisë Kulturore (Pikë)”, “Zonat e Mbrojtura të Trashëgimisë Kulturore (Poligon)”, “Zonat e Mbrojtura Natyrore të përgatitura nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM).
 - Tema “Zonat me Rreziqe Natyrore”, të dhënat për “Zjarret (2023)”, të përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC).
- Gjithashtu në Gjeoportalin Kombëtar janë publikuar Vendime të Këshillit të Ministrave për “V.K.M nr.637, dt.15.11.2023”, “V.K.M nr. 730 dt.13.12.2023”, “V.K.M nr. 764 dt. 20.12.2023”, “V.K.M nr. 827, dt. 28.12.2023”, “V.K.M nr. 643 dt. 16.10.2024”, “V.K.M nr. 644 dt. 16.10.2024”.

Të dhënat e sipërcituara janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar duke e çuar në total 394 numrin e shtresave të gjeoinformacionit, të publikuara.

- ASIG në bashkëpunim me Autoritetet Përgjegjëse po kryen hartëzimin e institucioneve publike. Deri më tani janë hartëzuar dhe publikuar në Gjeoportalin Kombëtar:
 - *Institucionet Publike:* Zyrat Rajonale të Punësimit, Zyrat ADISA, Zjarrfikëse, Prefekturat, Postat Sha, OSHEE, Njësitë Administrative, Ministrinë, Institucionet Në Varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Institucionet Në Varësi të Ministrisë së Jashtme, Institucionet Në Varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, Institucionet Në Varësi të Ministrisë së Kulturës, Institucionet Në Varësi të Ministrisë së Infrastrukturës Dhe Energjisë, Institucionet Në Varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Institucionet Në Varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Institucionet në Varësi të Ministrisë së Brendshme, Institucionet Në Varësi të Kryeministrisë, Federatat Sportive, Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoritë e Tatimeve, Dega Doganore, Bashkitë, Ambasadat dhe Agjencitë Shtetërore të Kadastrës.
 - *Sistemi i Drejtësisë*
 - *Institucionet Shëndetësore (Një pjesë e NJVKSH-ve)*

Në proces janë të dhënat për objektet e Arsimit, disa nga NJVKSH të Shërbimit Shëndetësor, institucionet në varësi të pushtetit lokal, etj..

- ASIG në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Turizmit dhe me 11 Bashkitë Bregdetare & Liqenore, në koordinimin e Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit , janë përgatitur Hartat e Stacioneve të Plazheve për Sezonin Veror 2025.

- Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore në autoritetet publike për sektorin e gjeoinformacionit, ASIG ka iniciuar trajnime të stafeve teknike duke filluar nga autoritetet publike përgjegjëse dhe të gjitha bashkitë në Republikën e Shqipërisë, për temat e gjeoinformacionit. Tematikat e trajtuara gjatë trajnimeve konsistojnë në:
 - Përdorimin e Gjeoportalit Kombëtar;
 - Standardizimin e të dhënave gjeohapësinore sipas temave të gjeoinformacionit;
 - Përmirësimin e proceseve të punës në institucionet përkatëse.

Gjatë viti 2024 janë realizuar trajnimet me:

- 58 Bashki;
 - Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN);
 - Hekurudhën Shqiptare;
 - Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH);
 - Autoritetin Portual Durrës;
 - Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare (KESH);
 - Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM);
 - Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM);
 - Agjencinë Kombëtare të Bregdetit (AKB);
 - Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP);
 - Agjencinë Kombëtare Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK);
 - Inspektoratin Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit (IKMT);
 - Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore Kadastra Kukës;
 - Zyrat Vendore të Agjencisë Shtetërore e Kadastrës Tropojë;
 - Agjencinë e Trajtimit të Pronave;
 - AKUK dhe Shoqëritë Rajonale;
 - Agjencinë për Mbikëqyrjen e Vetëqeverisjes Vendore.
- Është realizuar lidhja e kontratës për website zyrtar www.asig.gov.al duke përmirësuar platformën e përdorur, kontrata “Mirëmbajtje e faqes web” ka përfunduar në 09.08.2024. Sektori i Gjeoportalit Kombëtar ka vijuar rregullisht me përditësimin e informacionit për website www.asig.gov.al ,www.geoportal.asig.gov.al ,www.krgjsh.asig.gov.al mbi aktivitetet dhe çdo informacioni rreth ASIG.
- Në kuadër të projektit “Shërbime Satelitore” të Qeverisë Shqiptare me kompaninë Amerikane “Satellogic”, në datën 03.01.2023, janë lançuar në hapësirë satelitët Albania-1 dhe Albania-2. Pas një periudhe kolaudimi të orbitave ku do të lëvizin satelitët, si dhe të sensorëve që do të përdoren për mbledhjen e imazheve satelitore, në datën 19.01.2023 ka filluar fotografimi i territorit të Shqipërisë dhe marrja e imazheve satelitore me rezolucion 70 cm sipas zonës së interesit. Janë mbledhur gjithsej **701 imazhe satelitore** dhe është realizuar me sukses **2 herë mbulimi i pothuajse të gjithë zonës së interesit në vitet 2023 dhe 2024.**
 - Gjatë vitit 2024 janë mbledhur **323 imazhe satelitore** dhe është realizuar me sukses mbulimi i pothuajse të gjithë zonës së interesit.
 - Realizuar monitorimi i ecurisë së imazheve satelitore për të gjithë territorin e RSH.

- Realizuar **kontrolli dhe pranimi i produkteve të shërbimit satelitor** për 300 imazhe satelitore ku përfshihen: Kontrolli i saktësisë horizontale (RMSE) për çdo imazh satelitor; Kontrolli i secilit element për çdo skedar të imazheve satelitore që merren në dorëzim, si dhe hartimi i raporteve dhe statistikave për ecurinë e projektit "Shërbimi Satelitor".
- Janë realizuar dhe **publikuar shërbimet** në Gjeoportalin Kombëtar me produktet e mëposhtme:
 - Ortofoto e përftuar nga imazhet satelitore 2023,
 - Ortofoto CIR e përftuar nga imazhet satelitore 2023,
 - Ortofoto e përftuar nga imazhet satelitore 2024,
 - Ortofoto CIR e përftuar nga imazhet satelitore 2024.
- Janë realizuar **takime dhe trajnime** për rritjen e kapaciteteve teknike me qëllim ngritjen e kapaciteteve teknike të 14 autoriteteve publike përgjegjëse, përfituese të projektit "Shërbimi Satelitor" dhe 57 bashkive.
- Janë krijuar dhe shpërndarë e **hartat tematike për vlerësimin e dëmeve të zonave të prekura nga zjarri** në mbështetje të AKMC si më poshtë :
 - Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Dropull;
 - Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Finiq;
 - Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Delvine;
 - Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Stanet – Lazarat;
 - Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Veliqot – Luzat;
 - Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Tepelenë;
 - Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Shëngjin;
 - Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Gjadër;
 - Harta tematike e zonave të prekura nga zjarri në Malësi e Madhe.
- Realizuar **hartat tematike e ndërtesave me rrezik të lartë përmbajtje**, Web Map "Ndërtesat dhe infrastruktura rrugore brenda zonave me rrezik të lartë përmbajtje" ku janë paraqitur ndërtesat dhe akset rrugore me rrezik përmbajtje në basenin Drin-Bunë dhe janë publikuar në platformën ArcGIS Online këto produkte:
 - Ndërtesa;
 - Ortoimazheria për zonën përkatëse;
 - Akset e Rrugëve .
- Realizuar aplikacioni, Instant App "Njësitë administrative Rendi 3" (kufijtë e Bashkive) dhe Web Map për 61 bashki sipas kufijve administrativë të tyre, ku për secilën bashki janë publikuar këto produkte:
 - **Ortofoto;**
 - **Ortofoto CIR;**
 - **NDVI**- Indeksi i Bimësisë së Diferencës së Normalizuar (NDVI);
 - **NDWI**- Indeksi i Ujit të Diferencës së Normalizuar;
 - **EVI** - Indeksi i Përmirësuar i Vegjetacionit;
 - **SAVI** - Indeksi i Vegjetacionit të Rregulluar në Tokë;
 - **LAI** - Indeksi i Sipërfaqes së Gjethëve.
- Realizuar **Web map** "Mbulesa e Tokës", i përbërë nga shtresat:
 - **Ortofoto;**
 - **Mbulesa e Tokës**, publikuar deri më tani për 25 bashki;

-  Me bimësi
-  Pa bimësi
-  Pyje
-  Sipërfaqe ujore
-  Zonë urbane

- **Tabela e analizës** së shpërndarjes së sipërfaqeve për shtresat e mësipërme.
- Realizuar shpërndarja e produktit **identifikimi i ndërtesave** nëpërmjet platformës ArcGIS Online për 12 bashki, Web map “Ndërtesa Njësitë Administrative Rendi 3”.
- Realizuar shpërndarja e produktit **identifikimi i serrave bujqësore** nëpërmjet platformës ArcGIS Online për gjithë territorin e Shqipërisë, Web map “Serra Bujqësore Njësitë Administrative, Rendi 3”.
- Realizuar shpërndarja e produktit **identifikimi i sipërfaqeve ujore dhe analizimi i cilësisë së ujit** nëpërmjet platformës ArcGIS Online për 10 lumenj dhe 131 liqene, Web Map “Lumenjtë e Shqipërisë 2015-2023 & Cilësia e Ujit” dhe “Liqene 2023”.
- **Mbulimi me fotografi 360 gradë të gjeoreferencuara**, për monitorimin dhe identifikimin e gjendjes së infrastrukturës rrugore në Republikën së Shqipërisë **për rreth 1 806 km**, pjesë e infrastrukturës rrugore në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe bazuar kërkesat e AKB për evidentimin e zonave të grumbullimit të mbetjeve të jashtëligjshme në zonat bregdetare, duke përdorur kamera 360 gradë, i vlefshëm për krijimin e databazës imazherike. Gjithashtu është përfunduar edhe fotografimi i 3 akseve të reja rrugore (Orikum -Tuneli Llogarasë - Dhërmi; Kashar-Thumanë; Unaza e madhe e Tiranës), të cilat janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar dhe platformën ndërkombëtare Google maps.
- Realizimi i kërkesave të QKD dhe AKPT për **fotografimin dhe skanim Lidar** me teknologjinë UAV për përfitim e Ortofotos me rezolucion 3cm, izoipese me shpeshtësi çdo 1m, DTM, DSM.
- Realizuar projekti “Ndërtimi i Kornizës Referuese Gjeodezike, FAZA IV”, i cili ka si qëllim për herë të parë llogaritjen e versionit të parë të Gjeoidit në RSH. Janë implementuar me sukses aktivitetet e mëposhtme:
 - Realizimi i dendësimit të matjeve GNSS dhe matjeve Gravimetrike Relative 634 pikave;
 - Kryerja e nivelimit gjeometrik i nivelit të lartë të saktësisë 124.4 km/l;
 - Llogaritja dhe Validimi i gjeoidit Gravimetrikë: ALB – Geoid 2024 V.1.
- Realizuar monitorimi dhe verifikimi permanent i funksionimit të stacioneve ALBCORS, të rrjetit gjeodezik aktiv të KRGJSH-së për 27 stacione referencë, përgatitje e dokumentacionit dhe raporteve periodike.
- Realizuar menaxhimi dhe monitorimi i qendrës së rrjetit të stacioneve Mareografike, si dhe janë realizuar matjet GNSS në pikat e kontrollit të stacioneve Mareografik, gjithashtu janë llogaritur niveli mesatar i detit (MSL) e të katërt stacioneve Mareografike (2018 – 2024).

- Janë përgatitur specifikimet teknike si dhe ka përfunduar procedura e prokurimit për mirëmbajtjen e stacioneve të Rrjetit Gjeodezik Aktiv ALBCORS, për periudhën dy vjeçare (Janar 2024 - Dhjetor 2025).
- Realizuar verifikimi në terren i “hotspoteve” për krijimin e hartës bazë digjitale, dhe përpunimi i informacionit hartografik, për 96.3 km² në total, në të cilën përfshihen zonat rurale të Shkodrës me rrezikshmëri përmbetje, 29.3 km², zonat urbane qytetet Divjakë 4.0 km², Durrës 17.6 km², Belsh 5.7 km², Përmet 6.0 km², Rrogozhinë 5.7 km², Prrenjas 7.2 km², Peqin 4.8 km², Gramsh 5.2 km², Kuçovë 10.8 km² dhe publikimi i tyre në Gjeoportalin Kombëtar.
- Realizuar rlevimi 3D me metodën fotogrametrike në 200.3 km² të territorit të vendit, për krijimin e hartës bazë digjitale, për zonat prioritare për zhvillimin ekonomik dhe turistik kryesisht zonat urbane dhe një pjesë rurale në varësi të kërkesave të institucioneve veçanërisht nga ASHK dhe AKPT.
- Realizuar monitorim dhe asistencë për funksionimin e rrjetit gjeodezik të stacioneve mareografike (Sarandë, Orikum, Durrës, Shëngjin), përgatitje dokumentacioni dhe realizimi i tenderit për blerje pajisje për mirëmbajtje, si dhe realizuar raportimet periodike. Në bashkëpunim me Komandën e Forcave Detare janë kryer riparime dhe zëvendësimi i pajisjeve të dëmtuara në stacionet mareografike të instaluar në vendbanimet Pashaliman (Orikum) dhe Shëngjin.
- Realizimi i projektit të prodhimit të ortofotos (qytetet) nga fotografimi historik i viti 1972-1984. Informacioni është marrë nga arkiva e Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU), në proces mbetet publikimi i këtij informacioni në Gjeoportalin Kombëtar.
- Sipas parashikimit, në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve për vitin 2024, janë miratuar:
 - Ligji nr. 103/2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.
 - VKM nr. 732, datë 27.11.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 952, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit “Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri – tema: Imazhi i hartës bazë””
 - VKM nr. 753, datë 13.12.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”
- Janë realizuar 2 mbledhje të Bordit të Informacionit Gjeohapësinor (BIG), ku ASIG ka rolin e sekretariatit teknik, në të cilën janë trajtuar arritjet dhe ecuria e projekteve të ASIG, veçanërisht projekti i “Shërbimeve satelitore” dhe përdorimi nga autoritetet publike i produkteve të këtij projekti.
- Gjatë vitit 2024 ASIG ka nënshkruar një numër marrëveshjesh bashkëpunimi me autoritete publike, universitete dhe agjenci simotra në vendet e Ballkanit Perëndimor të cilat synojnë rritjen e kapaciteteve si dhe përdorimin e teknologjive inovative dhe inteligjente në fushën e gjeoinformacionit, të cilat janë:
 - Marrëveshje Bashkëpunimi me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK);

- Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”;
 - Marrëveshje Bashkëpunimi me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA);
 - Marrëveshje Bashkëpunimi me Korporatën e Investimeve Shqiptare (AIC);
 - Marrëveshje Bashkëpunimi me Agjencinë Kadastrale të Maqedonisë së Veriut (AREC).
- Është ndjekur dhe zbatuar Plani i komunikimit për aktivitetet, produktet trajnimet në fushën e gjeoinformacionit dhe bashkëpunimin e ASIG me aktorët e sektorit brenda vendit dhe me partnerët e huaj.
 - Janë realizuar të gjitha detyrimet e ASIG si autoritet koordinues i *NSDI*-së në Shqipëri në kuadër të procesit të Integritimit Evropian dhe janë kryer raportime periodike për implementimin e Direktivës INSPIRE, e cila tashmë është përafuar plotësisht me ndryshimet me ligjin nr. 103/2024, të ligjit nr. 72/2012.
 - Bazuar në Ligjin nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 7 dhe 22, ASIG, gjatë vitit 2024, ndërmori nismën për forcimin e kapaciteteve teknike të stafit të 16 Institucioneve Publike (IP) dhe 57 Njësive të Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V), me pjesëmarrjen e 534 nëpunësve të administratës publike duke realizuar:
 - Për NJ.Q.V - 34 seanca trajnimi të dedikuara me pjesëmarrjen e 469 përfaqësuesve.
 - Për IP - 9 seanca trajnimi të dedikuara me pjesëmarrjen e 65 përfaqësuesve.
 Kjo nismë synon krijimin, standardizimin dhe publikimin e të dhënave gjeohapësinore, si dhe ofrimin e njohurive mbi produktet e përfutuara nga shërbimet satelitore.
 - Në mbështetje të trajnimeve të ofruara, ASIG nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), më datë 4 korrik 2024. Kjo marrëveshje ka në fokus ofrimin e programeve të përbashkëta trajnimit duke përdorur ekspertizën e kombinuar të këtyre institucioneve, për të zhvilluar kurrikula të specializuara për të përmbushur nevojat specifike të profesionistëve të Administratës Publike.
 - Janë dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe SASPAC, për përfshirje në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare lista me gjashtë projekte (“Fotografimi Ajror për zonat me përparësi zhvillimi ekonomik”; “Platforma për Inteligjencën Gjeohapësinore (GEOINT)”; “Krijimi i Hartës Bazë në Republikën e Shqipërisë”; “Infrastruktura Kombëtare Informacionit Gjeohapësinor (NSDI)”; “Kapja e të Dhënave të Realitetit: Sistemi i Mobile Mapping LiDAR + 360 imazhe panoramike”; “Zhvillimi i platformës 3DModel për Smart Cities”) së bashku me formularët e plotësuar FKPI dhe FVRS.
 - Janë zhvilluar takime dhe monitoruar në mënyrë të vazhduar SASPAC, AKKSHI, "Instrument for Pre-accession Assistance (IPA)", Europa.eu, European Space Agency, dhe organizma të tjerë për të identifikuar projekte dhe mundësi bashkëpunimi dhe është bërë vlerësimi i këtyre mundësive në raport me kapacitetet dhe fushëveprimin e ASIG.
 - Është përgatitur për implementim projekti "SOFTMOVE" pjesë e Programme INTERREG IPA SOUTH ADRIATIC 2021-2027 (projekti do të zhvillohet përgjatë vitit 2025).

II. Problematikat e evidentuara

- **Mungesa e mirëmbajtjes së Sistemit të Gjeoportalit Kombëtar**

Sistemi i Gjeoportalit Kombëtar aktualisht nuk ka një kontratë mirëmbajtjeje funksionale, gjë që e bën emergjente realizimin e procedurave përkatëse nga Autoriteti Kombëtar për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), në rolin e autoritetit kontraktor.

➤ **Projekti për ndërtimin e Sistemit të GIS Kombëtar**

Realizimi i projektit “Ndërtimi i Sistemit të GIS Kombëtar” është një prioritet, dhe procesi i prokurimit duhet të kryhet nga AKSHI. Ky projekt synon përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 28.09.2023, për miratimin e dokumentit “Standardet Shtetërore të GIS-it Kombëtar”.

➤ **Cilësia dhe disponueshmëria e të dhënave gjeohapësinore**

Është e domosdoshme të sigurohet një koordinim efektiv me autoritetet publike përgjegjëse për temat prioritare të gjeoinformacionit. Ky bashkëpunim synon standardizimin dhe rritjen e aksesueshmërisë së të dhënave gjeohapësinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

➤ **Investime për përmirësimin e informacionit gjeohapësinor**

Për përditësimin dhe përmirësimin e temave të gjeoinformacionit të përcaktuara në Nenin 11, të Ligjit nr. 72/2012, i ndryshuar, janë të nevojshme investime të rëndësishme për prodhimin e informacionit gjeohapësinor referencë, duke përfshirë Hartat Bazë, Ortoimazherinë dhe Modelet Digjitale të Terrenit.

➤ **Sigurimi i buxhetit të nevojshëm për investime në realizimin e projektit thelbësor për:**

- Ndërtimin e Infrastrukturës për të mbështetur veprimtarinë e Drejtorisë së Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing;

ASIG në bashkëpunim me AKSHI ka hartuar specifikimet teknike për “Ndërtimin e infrastrukturës për të mbështetur veprimtarinë e drejtorisë së përpunimit të informacionit të territorit me teknologji të avancuar (Drejtoria e Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing)”, për ndërtimin e kësaj infrastrukture për administrimin dhe arkivimin e të dhënave, si dhe për sigurimin e infrastrukturës Harduer dhe Softuer për përpunimin e të dhënave të përfuara. Aktualisht nuk është miratuar ende financimi nga Ministria e Financave për vijimin e procedurave më tej dhe për realizimin e kësaj procedure

- Mungesa e një linje të dedikuar interneti me parametra sipas kërkesave që kërkon aplikimi i modeleve *Deep Learning*.
- Të krijohet mundësia e Integritimit të pajisjes GNSS Rover, e cili mundëson qëndrueshmërinë e lidhjes me shërbimin RTK (ALBCORS) në funksion të përmirësimit të saktësisë të produkteve hartografike nga përdorimi i teknologjisë UAV.
- Pajisja me certifikatat profesionale dhe konsultim nga Autoriteti i Aviacionit Civil si autoritet përgjegjës për zbatimin e Urdhrit “Për Miratimin e Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot” në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë për modalitetet e nevojshme për aprovimin e lejeve përkatëse.

- Mungesa e financimit të plotë për realizimin e projektit të fotografimit 360° në rrugët kombëtare dhe zonat urbane brenda vitit për gjithë akset rrugore i vlefshëm për krijimin e databazës imazherike, të tillë mund të realizohen me efektivitet të lartë dhe me kosto të ulët:
 - Kontrolli i mirëmbajtjes së akseve rrugore, të cilat i janë kontraktuar operatorëve ekonomikë;
 - Kontrolli i investimeve të kryera në akse rrugore (sinjalistikë, gjelbërim, ndriçim, etj.);
 - Përcaktimi i zonave që kërkojnë ndërhyrje në kuadër të mirëmbajtjes;
 - Përcaktimi i investimeve në akset rrugore, në të cilat nuk janë kryer investime.

III. Objektivat Viti 2025

➤ Sistemet e Gjeoinformacionit

Realizimi i projekteve për mirëmbajtjen e Gjeoportalit Kombëtar dhe “Ndërtimi i Sistemit të GIS Kombëtar” përbëjnë prioritetet kryesore të Drejtorisë së GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit.

➤ Ndërveprimi me sistemet GIS shtetërore

Sigurimi i ndërveprimit të Sistemit të Gjeoportalit Kombëtar me sistemet GIS shtetërore, si:

- Planifikimi i Territorit (AKPT);
- Sistemi i Adresave (DPGJC);
- Sistemi i Informacionit për Tokën Bujqësore (QTTB);
- Sistemi E-Leje (AZHT).

➤ Përgatitja dhe publikimi i të dhënave gjeohapësinore

Përgatitja e të dhënave për publikim në Gjeoportalin Kombëtar është planifikuar për vitin 2025 dhe përfshin tematika si:

- Sistemi i Adresave;
- Parcelat dhe Ndërtesat Kadastrale (ALBSCAD);
- Institucionet Publike;
- Rrjetet e Transportit;
- Rrjetet Inxhinierike (ujësjellës-kanalizime);
- Të dhënat nga Projekti i Shërbimeve Satelitore;
- Ortofoto Historike (1976-1980);
- Korniza Referuese Gjeodezike, përfshirë Rrjetin Gravimetrik (Gjeoid).

Bashkëpunimi me autoritetet publike për azhurnimin dhe përmirësimin e cilësisë së të dhënave sipas standardeve të gjeoinformacionit është gjithashtu një fokus kryesor.

➤ Zhvillimi i aktiviteteve për ndërtimin e NSDI

- Trajnimi i stafit të bashkive për përdorimin e Gjeoportalit Kombëtar dhe mbledhjen e të dhënave për temat si: Njësitë administrative (rendi 4), Rrjeti i transportit rrugor lokal, dhe identifikimi i pikave të interesit.
- Organizimi i workshop-eve dhe takimeve me autoritetet publike përgjegjëse mbi sistemin e GIS-it Kombëtar.

➤ **Asistenca për zhvillimin e infrastrukturës së gjeoinformacionit**

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit: hartimi i hartave të stacioneve të plazhit për sezonin 2025.
- AKUM dhe UK-të rajonale: krijimi i të dhënave për temën “Infrastruktura Urbane dhe Shërbimet Qeveritare”, nën tema “Infrastruktura Ujësjellës-Kanalizime”.
- Instituti i Transportit: përmirësimi i të dhënave për temën “Rrjetet e Transportit - Transporti Rrugor”.
- Albcontrol: azhurnimi i hartave aeronautike për Republikën e Shqipërisë.

➤ **Bashkëpunimi ndërkombëtar për hartografi**

- Bashkëpunimi me Google për publikimin e të dhënave në Google Maps (ndarje administrative, emërtime gjeografike, pika interesi, sistemi i adresave).
- Pjesëmarrja në takimet e Grupit Teknik për INSPIRE MIG-T.
- Projekti me Eurogeographics “OME2 National Large-Scale Data Collection”.

➤ **Përmirësimi i infrastrukturës IT në ASIG**

- Monitorimi dhe mirëmbajtja e kontratës për softuerët inxhinierikë GIS.
- Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ASIG dhe publikimi periodik i informacioneve mbi aktivitetet e institucionit.
- Realizimi i backup-it të të dhënave dhe sistemeve nga projektet e ASIG (Shërbime Satelitore, Harta Bazë, Albcors, Mareografë).

Ndjekja e implementimit të projektit “Për realizimin e “Shërbimit Satelitor” për monitorimin me teknologji të avancuar të territorit të Republikës së Shqipërisë”.

- Kontrolli dhe pranimi i produkteve të shërbimit satelitor sipas urdhrin nr. 134, datë 22.06.2023.
- Krijimi dhe përditësimi i shërbimeve të produkteve të projektit "Shërbimi Satelitor".
- Krijimi i hartave tematike për produktet e projektit të "Shërbimi Satelitor" në funksion të plotësimit të kërkesave të institucioneve shqiptare sipas zonave të tyre të interesit:
 - Ortofoto me imazhet satelitore për territorin e RSh;
 - Identifikimi i ndërtesave dhe ndryshimet e tyre;
 - Identifikimi i serave dhe ndryshimet e tyre;
 - Identifikimi i sipërfaqeve pyjore dhe ndryshimet e tyre në kohë;
 - Harta tematike Mbulesa e Tokës;
 - Identifikim i sipërfaqeve ujore si dhe ndryshimet e tyre në kohë;
 - Hartë tematike për indeksin e shëndetit të bimësisë;
 - Hartë tematike për cilësinë e ujit.

- Ndjekja e implementimit të projekteve që lidhen me mbledhjen e informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet teknologjisë UAV për 12 zona urbane.
- Ndjekja e implementimit të projekteve që lidhen me mbledhjen e informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet fotografimit me kamera "Street View 360°" për 16 zona urbane.
- Realizimi i Projektit "Ndërtimi i Kornizës Referuese Gjeodezike, FAZA V", i cili ka si qëllim përmirësimin e rrjetit gjeodezik aktiv (ALBCORS), dendësimin e Rrjetit Gravimetrik të Rendit III dhe vazhdimin e realizimit të linjave të nivelimit të klasit të parë, afërsisht 145 km/l në funksion të përcaktimit të Referencës Gjeodezike Vertikale të Re, me saktësi të lartë për mbështetjen e të gjitha punimeve gjeodezike, inxhinierike dhe shkencore.
- Ndjekja e Projektit "Mirëmbajtja e Rrjetit Gjeodezik ALBCORS". Monitorimi dhe kontrolli i funksionimit të ALBCORS.
- Menaxhimi dhe monitorimi i qendrës së rrjetit të stacioneve Mareografike. Realizimi i matjeve GNSS në pikat e kontrollit të stacioneve Mareografike.
- Prodhimi i Hartës Bazë digjitale. Planifikohet të realizohet rilevimi fotogrametrik 3D në zonat urbane dhe rurale për 250 km². Kontrolli, editimi, verifikimi në teren, strukturimi dhe përpunimi bazës së të dhënave hartografike të përfuara nga prodhimi i hartës bazë.
- Prodhimi i Ortofotos së 6 qyteteve kryesore nga fotografimi ajror i vitit 2023. Hartimi i specifikimeve teknike, ndjekja e projektit dhe përgatitja e të dhënave për publikim në Gjeoportalin Kombëtar.